

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 24-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuele**  
**mbajtur më 30.05.2024**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë:** Llazar Trajçev.

**Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.**

**Të pranishëm nga Shërbimi Profesional:** mr. Dragica Ljubevska, mr. Emilija Janevska, mr. Emilija Petreska Kamenjarova, Maja Damevska, Jeton Ismaili.

**Të pranishmit e tjerë: /**

Z. Petrushevski hapi seancën e 24-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:30 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 5 vota "pro", miratoi:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 23-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 23.05.2024.
2. Raport mbi prezantimin mediatik zgjedhor në rrethin e dytë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Presidenciale 2024.
3. Raport mbi prezantimin mediatik zgjedhor për Zgjedhjet Parlamentare 2024.
4. Të ndryshme.

**Pika 1**

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi dhe me 4 vota "pro" dhe një abstenim nga z Jançeski miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 23-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 23.05.2024, me tekstin e propozuar.

## **Pika 2**

Z. Trajçevski shpjegoi Raportin mbi prezantimin mediatik zgjedhor për rrethin e dytë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Presidenciale 2024. Ai sqaroi se në rrethin e dytë kanë hyrë dy kandidatë, kandidatja prof. dr.Gordana Siljanovska-Davkova, tani kryetare dhe prof.dr. Stevo Pendarovski. Të gjitha televizionet nga ekzemplari për monitorim për pasqyrimin mediatik të Zgjedhjeve Presidenciale i respektuan parimet nga neni 75 paragrafi (1) dhe nga neni 75-a paragrafi (1) pika a e Kodit Zgjedhor, pra raportuan në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme. Ai tha se si shtojcë të Raportit të propozuar janë dhe analizat e detajuara që janë bërë për shërbimin publik si dhe për të gjithë transmetuesit e tjerë komercial që kanë mbuluar raportimin për rrethin e dytë të Zgjedhjeve Presidenciale 2024.

## **Pika 3**

Z. Trajçevski shpjegoi Raportin mbi prezantimin mediatik zgjedhor për Zgjedhjet Parlamentare 2024. Ai sqaroi se për Zgjedhjet Parlamentare ishin 17 lista, nga ku shumica e të cilave janë prezantuar në 6 njësi zgjedhore, ndërsa një pjesë e vogël janë prezantuar në më pak se 6 njësi zgjedhore. Ai ka thënë se Zgjedhjet Parlamentare janë përputhur me rrethin e dytë të Zgjedhjeve Presidenciale, duke e bërë procesin shumë specifik dhe delikat që të mund transmetuesit t'i ndjekin këto dy cikle zgjedhore paralel. Asnjë nga transmetuesit për shkak të procesit të ndërlikuar nuk arriti të përmbushë parimet e Kodit Zgjedhor, pra të mbulojë njoftimin për të 17 pjesëmarrësit.

Z. Fidanoski tha se të dy Raportet që janë në Rendin e ditës janë përgatitur mirë dhe në detaje nga shërbimi i Agjencisë. Në dispozicion janë të gjitha të dhënat e nevojshme, por për shkak të ndërlikueshmërisë dhe përputhjes së dy proceseve zgjedhore, transmetuesit nuk arritën të përmbushin plotësisht detyrimin e tyre për mbulimin mediatik. Duke qenë se kam punuar 13 vite në televizion, ai e di se sa kërkon logjistikë dhe kërkesë, njëkohësisht në vende të ndryshme disa ekipe të jenë të pranishëm për t'i regjistruar të gjitha, pastaj për t'i redaktuar dhe në të njëjtën kohë deri në sekonda për tu respektuar ligji. Ai bëri një llogaritje të përafërt se edhe 20 gazetarë do të duhej të ketë çdo redaksi informative në televizion dhe radio, gjë që sipas tij në këto kushte siç funksionon tregu mediatik është praktikisht e pamundur. Në këtë drejtim, ai tha se e kupton plotësisht pse nuk e kanë bërë këtë transmetuesit, jo se nuk kanë dashur, por objektivisht nuk kanë mundur. Sipas shifrave, ishin mbuluar një numri më i madh i pjesëmarrësve, dhe disa nga ata që nuk ishin mbuluar, realisht nuk ishin aktiv gjatë procesit zgjedhore. Por kjo tregon se media e ka bërë mirë punën e saj.

Z. Ajdini tha se të gjithë këtu ndoshta pajtohen se zgjedhjet që kaluan ishin të vështira dhe zgjatën më shumë kohë. Ai pajtohet me mendimin se jo vetëm mediat kanë pasur një sërë vështirësish, por edhe shërbimi profesional i Agjencisë, veçanërisht Sektori për Çështjeve Programore ku kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm. Në këtë drejtim, ai vlerësoi punën e bërë nga shërbimi, në veçanti për udhëheqësen mr. Emilija Janevska, zëvendës udhëheqësen mr.Emilija Petreska Kamenjarova, të cilët bënë të pamundurën që monitorimi të bëhej në mënyrë profesionale, duke filluar nga Tabelat që janë në Raport që tregojnë rezultatet e shprehura në sekonda për gjithçka që u transmetua në programet e mediave. Ai llogarit se për shkak të ndërlikueshmërisë së Ligjit, veçanërisht shërbimi publik radiodifuziv me ndarjen matematikore të kohës nuk arriti të sigurojë një ekuilibër thelbësor në raportim. Po ashtu kjo u reflektua edhe në mediat private, të cilat bënë shumë përpjekje për të krijuar një

balancë në prezantimin mediatik zgjedhor. Në fund ai tha se mediat e kanë kryer mirë punën e tyre.

Udhëheqësja e Sektorit për Çështje Programore, mr. Emilija Janevska, sqaroi se në edicionin e lajmeve mediat kanë bërë përpjekje që të realizohen emisione të veçanta informative për pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore dhe emisionet debatuuese. Si një element i rëndësishëm ajo përmendi se detyrimi që për herë të parë është aplikuar në këto zgjedhje për të siguruar qasje të përmbajtjeve për personat me aftësi të kufizuara shqisore, të gjithë transmetuesit e kanë përmbushur këtë detyrim dhe kjo mund të jetë një hyrje e mirë për detyrimet që do t'i zbatojnë vitin e ardhshëm dhe zbatimin e LSHMAAV me ndryshimet e fundit. Sa i përket prezantimit mediatik zgjedhor, ajo tha se edhe këto procese zgjedhore kanë treguar se pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore nuk kanë fare interes për prezantimin mediatik falas, dhe nga ana tjetër interesim të madh për reklamën politike me pagesë. Sa i përket reklamimit politik me pagesë, ajo tha se për këto zgjedhje ka një rekord absolut, 5 milionë sekonda për RPP për të dy proceset zgjedhore.

Z. Petrushevski tha se në të ardhmen dikush i arsyeshëm do ta lexojë këtë Procesverbal dhe fjalët e Janevskës do t'i marrë parasysh, veçanërisht për statusin e reklamimit të paguar politik. Këto Raporte që shërbimi i punoi do të mbeten si një dokument i përhershëm, do të publikohen në ueb-faqe, dhe nuk beson se dikush tani është i interesuar ta shikojë, por në të ardhmen, ndoshta ndonjë analist do ta përdorë për punim profesional.

Z. Fidanoski përshëndeti përpjekjen e suksesshme të transmetuesve për të siguruar qasje të përmbajtjeve për personat me aftësi të kufizuara shqisore. Ai beson se kjo do të jetë një bazë e mirë zgjerimi për ciklet e ardhshme zgjedhore për pjesën tjetër të programit. Në raporte ka matje të sakta të shprehura në sekonda nga shërbimi i Agjencisë se si është trajtuar prezantimi mediatik zgjedhor dhe RPP, por ajo që sipas tij ishte e dukshme dhe vizuale, është pluralizmi politik që ka qenë i pranishëm dukshëm në media për të gjithë periudhën zgjedhore.

#### **Pika 4**

##### **Të ndryshme**

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**